

Vendim nr. 68 datë 05.04.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 05.04.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 1 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERION ÇAVOLLI, përfaqësuar nga avokat Shuaip Syri.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-1467(250), datë 21.09.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës të Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, 30, 31, 32 pika 2, 33, 34, 43, 131, pika 1, shkronja “f” 132, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligjin nr. 7760, datë 14.10.1993, “Për ratifikimin e Konventës ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Greqisë për ndihmën gjyqësore në çështjet civile dhe penale (*ligji nr.7760/1993*); ligji nr. 10193, datë 03.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështje penale” (*ligji nr. 10193/2009*); ligji nr. 8497, datë 10.06.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për transferimin e procedimeve të çështjeve penale” (*ligji nr. 8497/1999*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Erion Çavolli, me vendimin penal nr. 276, datë 19.06.2013 të Gjykatës Treanëtarëshe të Fajit Thesprotia, Greqi, është deklaruar fajtor dhe dënuar për kryerjen e veprës penale “Nxitja për hyrje dhe qëndrim të paligjshëm të emigrantëve”, të parashikuar nga nenet 1, 12, 14, 26/1/a, 27/1, 46/1/a, 51, 53, 57 të Kodit Penal të Republikës së Greqisë dhe, gjithashtu, me gjobë në vlerën 29 000 euro, të parashikuar nga neni 88/1/b të ligjit grek nr. 3386/2005 “Për hyrjen, qëndrimin dhe integrimin social të shtetasve të vendeve jo anëtare”, pasi në datën 14.04.2007 kërkuesi, për qëllime përfitimi, ka ndihmuar disa persona për hyrjen në mënyrë të paligjshme në shtetin grek dhe transportimin e tyre drejt Athinës.

2. Nga autoritetet e drejtësisë greke, mbështetur në marrëveshjen dypalëshe midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë “Për zbatimin reciprok të vendimeve gjyqësore në çështjet penale” të vitit 1993, është kërkuar njohja dhe ekzekutimi në Shqipëri i vendimit penal nr. 276, datë 19.06.2013. Kjo kërkesë i është përcjellë Prokurorisë së Përgjithshme nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë me shkresën nr. 2984/1, prot./A.H., datë 01.09.2016. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 2567/1 prot./G.K., datë 07.09.2016, ka përcjellë materialet e çështjes në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Kjo e fundit, pasi është njohur me materialet e çështjes, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat me kërkesë për njohjen e vendimit penal nr. 276, datë 19.06.2013 të gjykatës greke. Sipas prokurorisë, kjo veprë penale kualifikohet në Kodin Penal (*KP*), sipas nenit 298, paragrafët 2 dhe 3, “Ndhim për kalim të paligjshëm të kufirit”, të kryer në bashkëpunim me qëllim fitimi. Gjithashtu, prokuroria ka kërkuar dënimin e kërkuesit me 3 vjet burgim, bazuar në paragrafin 2 të nenit 298 të *KP*-së dhe 5 vjet burgim, bazuar në paragrafin 3 të po këtij neni. Në bashkim të dënimeve, referuar nenit 55 të *KP*-së, prokuroria ka kërkuar përfundimisht dënimin me 7 vjet burgim. Për sa i përket gjobës prokuroria ka kërkuar mosnjohjen e saj, pasi nuk parashikohet në *KP*.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 385, datë 07/12/2016, bazuar në ligjin nr. 10193/2009 dhe në *KP* ka vendosur njohjen e vendimit penal të huaj me nr. 276, datë

19.06.2013 të Gjykatës Treanëtarëshe të Fajit Thesprotia, Greqi dhe konvertimin e tij me 3 vjet burgim për veprën penale, të parashikuar nga paragrafi 2 i nenit 298 të KP-së, 5 vjet për veprën penale, të parashikuar nga paragrafi 3 i nenit 298 i KP-së dhe bazuar në nenin 55 të KP-së, në bashkim të veprave penale, në përfundim gjykata ka vendosur dënimin e kërkuarit me 5 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuari.

4. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 219, datë 25/10/2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 385, datë 07.12.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, refuzimin e njohjes së vendimit penal të huaj nr. 276, datë 19.06.2013 të Gjykatës Treanëtarëshe të Fajit Thesprotia, Greqi, me arsyetimin se moskaktimi i një mbrojtësi kryesisht prej kësaj gjykate është në shkelje të nenit 6 të KENDJ-së dhe, gjithashtu, bie ndesh me parimet themelore të legjislacionit procedural penal, të parashikuara në nenin 31 të Kushtetutës. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

5. Me vendimin nr. 00-2023-1467(250), datë 21.09.2023, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe lënien në fuqi të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me arsyetimin se vendimi nr. 219, datë 25.10.2017 i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në zbatim të gabuar të dispozitave procedurale penale dhe konventave të nënshkruara nga shteti shqiptar në fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë.

6. Në datën 01.02.2024 kërkuari i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuarit

7. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt, në drejtim të:

7.1. *Së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u mbrojtur* pasi kërkuari nuk ka marrë njoftim për datën dhe orën e gjykimit të kryer në shtetin grek dhe nuk i është caktuar mbrojtës kryesisht. Gjykata greke duhej të kryente njoftimin e kërkuarit me letërporosi, duke i dërguar edhe aktet bashkëlidhur në IEVP-në, Lushnje, aty ku kërkuari po vuante një dënim tjetër. Ai është gjykuar e dënuar vetëm se është shqiptar, siç janë dënuar shumë shtetas të tjerë shqiptarë në Greqi.

- 7.2. *Së drejtës për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Penal nuk duhej ta shqyrtonte çështjen në dhomë këshillimi por kishte detyrimin që bazuar në Kodin e Procedurës Penale (KPP), të dëgjonte kërkuuesin dhe mbrojtësin e tij edhe për sa i takon shuarjes së dënimit, pasi kishin kaluar 10 vjet nga marrja e formës së prerë të vendimit të Gjykatës Treantareshe të Fajit Thresprotia, Greqi, i cili nuk ishte ekzekutuar.
- 7.3. *Marrjes së provave në mënyrë të paligjshme*, për shkak të procesit të parregullt të marrjes së tyre.

III Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuësit

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

10. Në drejtim të përmbushjes së këtyre kriterëve, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

11. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas

përfundimit të procesit gjyqësor për njohjen e vendimit të huaj penal në të tria shkallët e gjykimit të zakonshëm dhe, në këtë kuptim, ai i ka shteruar mjetet e ankimit, duke mos pasur mjet tjetër ankimi në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

12. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 01.02.2024, ndërsa vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është i datës 21.09.2023. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Gjykata e Lartë, rezulton se ky vendim është bërë i disponueshëm për palët, në faqen zyrtare të gjykatës, në datën 28.12.2023, për rrjedhojë Kolegji vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspekt të së drejtës për t’u njoftuar, për t’u mbrojtur, për t’u dëgjuar si dhe marrjes së provës në mënyrë të paligjshme. Për sa i përket pretendimit për marrjen e provës në mënyrë të paligjshme, Kolegji vëren se ai ka të bëjë me gjykimin e çështjes së themelit nga gjykata greke. Në kushtet kur gjykatat shqiptare nuk e gjykojnë çështjen në themel, por verifikojnë nëse vendimi i huaj plotëson kushtet e njohjes, të përcaktuara nga KPP-ja, ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për t’u njoftuar dhe mbrojtur, Kolegji vlerëson që këto pretendime do t’i analizojë në këndvështrimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Këto pretendime, ashtu siç edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar, hyjnë në kompetencën e Gjykatës, për rrjedhojë Kolegji do t’i analizojë ato në vijim.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për t’u dëgjuar

14. Kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Penal nuk duhej ta shqyrtonte çështjen në dhomë këshillimi por kishte detyrimin që bazuar në dispozitat e KPP-së ta dëgjonte kërkuesin dhe mbrojtësin e tij në lidhje edhe me shuarjen e dënimit, pasi kanë kaluar 10 vjet nga marrja e formës së prerë të vendimit të Gjykatës Greke i cili nuk ishte ekzekutuar.

15. Jurisprudenca e Gjykatës ka pranuar si elemente përbërëse të procesit të rregullt ligjor edhe të drejtën për t’u dëgjuar. Kjo e drejtë, në unitet edhe me të drejta të tjera, ka për qëllim garantimin e një procesi gjyqësor ku individit i krijohen mundësitë që, përpara marrjes së vendimit gjyqësor, të dëgjohet realisht për thelbin e çështjes. Nëpërmjet pjesëmarrjes dhe krijimit të kushteve për t’u dëgjuar, individëve u krijohen mundësi të barabarta për deklaratimet e tyre, për parashtrimin e

fakteve, provave e vlerësimeve ligjore (*shih vendimet nr. 7, datë 12.03.2010; nr.12, datë 06.06.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në lidhje me gjykimin në Gjykatën e Lartë, Gjykata është shprehur se kjo e fundit ka detyrimin që jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t'u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Gjykata e Lartë duhet t'u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t'i kundërshtojnë ato ose të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr.17, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në referim të ndryshimeve të reja të KPP-së për shqyrtimin e çështjeve në dhomë këshillimi, në nenin 436 të tij përcaktohen rregullat e shqyrtimit të çështjeve sipas kësaj forme gjykimi, dhe po ashtu edhe mënyra e njoftimit të palëve. Shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi, pra mbi bazë dokumentesh, është forma e gjykimit që ndiqet, si rregull, në Gjykatën e Lartë, e përcaktuar nga neni 436/a, pika 1, i KPP-së.

18. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Kolegji konstaton se pas paraqitjes së rekursit nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, kërkuesi është njohur me shkaqet e rekursit duke pasur kohën e mjaftueshme për të paraqitur pretendimet e tij, gjë të cilën nuk e ka kryer. Po kështu, nga dokumentacioni i paraqitur për qëllim të këtij gjykimi, nuk rezulton se kërkuesi nuk ka pasur dijeni për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes, pasi në lidhje me to ai nuk ka paraqitur asnjë pretendim. Në këto kushte, Kolegji vlerëson se Gjykata e Lartë ka vepruar konform dispozitave procedurale të zbatueshme për shqyrtimin e çështjeve në atë gjykatë.

19. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar është haptazi i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit

20. Kërkuesi ka pretenduar se nuk është njoftuar për datën dhe orën e gjykimit të çështjes së tij në gjykatën greke dhe, gjithashtu, nuk i është caktuar mbrojtës kryesisht nga gjykata.

21. Gjykata në jurisprudencën e saj ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë (*shih vendimet nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 3, datë 20.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në

përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradikcion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 16, datë 16.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Kolegji thekson se detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm është të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e kësaj Gjykate është të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrarisht, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa i takon procesit me objekt njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale të huaja, të parashikuar në nenet 512 e vijues të KPP-së, gjykata që shqyrton kërkesën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal nuk gjykon çështjen në themel, por verifikon nëse vendimi i huaj plotëson kushtet e njohjes të përcaktuara në nenin 514 të KPP-së. Duke shqyrtuar përmbajtjen e konventave dhe të dispozitave procedurale penale, procedura e mësipërme nuk përbën shqyrtim në themel të çështjes, por një shqyrtim gjyqësor të veçantë, ku duhet të zbatohen një sërë principesh themelore të gjykimit. Në këtë fazë, gjykata shqyrton nëse ekzistojnë ose jo kushtet e njohjes, të parashikuar nga neni 514 i KPP-së dhe cakton dënimin që duhet të vuajë individi në përputhje me legjislacionin shqiptar për të njëjtin fakt të pranuar nga gjykata e huaj (*shih vendimet nr. 35, datë 01.06.2015; nr. 6, datë 30.03.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se në zbatim të nenit 512 të KPP-së, bazuar në kërkesën e shtetit grek për njohjen dhe ekzekutimin e vendimit penal nr. 276, datë 19.06.2013 të gjykatës greke, institucionet e drejtësisë shqiptare kanë vijuar procedurat për njohjen e këtij vendimi. Nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore rezulton se gjykatat kanë respektuar kërkesat e neneve 512, 513 dhe 514 të KPP-së. Veprat penale për të cilat është dënuar kërkuesi parashikohen edhe nga legjislacioni penal shqiptar dhe nuk rezulton që ai të jetë dënuar për këto vepra penale në Shqipëri. Gjithashtu, nuk ka rezultuar që vendimet e gjykatave të huaja të jenë ndikuar nga elemente diskriminuese, si: raca, gjinia, feja, gjuha ose bindjet politike. Kërkuesi është dënuar në shtetin grek për veprën penale “Nxitja për hyrje dhe qëndrim të paligjshëm të emigrantëve”, të parashikuar nga nenet 1, 12, 14, 26/1/a, 27/1, 46/1/a, 51, 53, 57 të Kodit Penal të Republikës së Greqisë dhe me gjobë 29 000 euro bazuar në nenin 88/1/b të ligjit grek nr. 3386/2005 “Për hyrjen, qëndrimin dhe integrimin social të shtetasve të vendeve jo anëtare”. Këto vepra penale i korrespondojnë dhe përputhen me veprat penale të “ndihmës për kalim të paligjshëm të kufirit për qëllime fitimi”, dhe “ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit kryer në bashkëpunim”, të parashikuar nga paragrafët 2 dhe 3 të nenit 298 i KP-së. Për sa i përket gjobës gjykatat kanë vendosur mosnjohjen e saj duke qenë se legjislacioni shqiptar nuk e parashikon.

26. Në lidhje me përcaktimin e masës së dënimit, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shqiptar në rrethanat kur nga gjykata greke është vendosur dënimi me 7 vjet burgim dhe 29 000 euro gjobë, kanë vendosur që bazuar në nenin 47 të KP-së të konvertojnë dënimin nga 7 vjet në 5 vjet burgim dhe, gjithashtu, të mos njohin vendimin, për sa i përket gjobës prej 29 000 eurosh. Gjithashtu, gjatë këtij procesi për njohjen e vendimit të gjykatës së huaj rezulton se kërkuesi është përfaqësuar me avokat.

27. Në lidhje me pretendimin se kërkuesi nuk është njoftuar nga gjykatat greke për ditën, datën dhe orën e gjykimit, pa iu caktuar mbrojtje, sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, rezulton se gjatë periudhës që gjykohej në Greqi çështja në fjalë, kërkuesi ndodhej në Shqipëri ku ishte proceduar dhe vuante dënimin për një vepër tjetër penale. Në datat 08.05.2013 dhe 30.04.2013 të akuzuarit janë njoftuar ligjërisht për orën dhe datën e gjykimit të çështjes dhe, gjithashtu, në njoftim i është bërë me dije se nëse nuk paraqiten vendimi mund të shpallet sikur të ishin prezentë. Në këto rrethana, gjykata e rrethit ka konkluduar se vendimi penal i huaj i plotëson kushtet e parashikuara në nenin 514 të KPP-së. Ndërsa Gjykata e Apelit Vlorë, mbi bazën e ankimit të kërkuesit, ka vendosur refuzimin e njohjes së vendimit penal të huaj me arsyetimin se pavarësisht

se prej autoritetit të huaj janë respektuar dispozitat e legjislacionit të brendshëm lidhur me njoftimin e të pandehurit, ai nuk mund të gjykohej pa iu garantuar e drejta e mbrojtjes me anë të një mbrojtësi të caktuar nga vetë gjykata. Mbi bazën e rekursit të prokurorit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit. Kolegji ka theksuar se në zbatim të detyrimeve që burojnë nga nënshkrimi i konventave evropiane dhe marrëveshjeve ndërkombëtare (të ratifikuara nga Shqipëria), gjykata shqiptare kur bën njohjen e vendimit penal të gjykatës së huaj, nuk shqyrton çështjen në themel dhe nuk verifikon provat e administruara nga gjykata e huaj. Ajo vetëm verifikon nëse ekziston ndonjë nga kushtet për mosnjohjen e vendimit të huaj, të parashikuar në nenin 514 të KPP-së dhe më tej konverton dënimin e caktuar në vendimin e huaj, me një nga dënimet e parashikuara për të njëjtin fakt nga ligji shqiptar, sipas nenit 516 të këtij kodi. Sipas kolegjit penal nuk rezulton që vendimi penal të përmbajë disponime në kundërshtim me parimet e rendit juridik shqiptar.

28. Në përputhje me standardet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese, për sa i përket respektimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor gjatë procesit për njohjen e vendimit të huaj, Kolegji thekson se nuk është pjesë e juridiksionit kushtetues debati mbi rrethanat faktike të kryerjes së veprës penale, verifikimin e provave ose vlerësimin e ligjit procedural të gjykatave të shteteve të tjera dhe se interpretimi i ligjit është në juridiksionin e gjykatave të zakonshme. Nëpërmjet vendimeve të tyre, gjykatat e zakonshme rezulton se i kanë dhënë përgjigje të shprehur kërkuarit për çështjen e njoftimit dhe për të drejtën e mbrojtjes, në këtë kuptim ato i plotësojnë standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

29. Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit është haptazi i pabazuar.

30. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.